

Die Schulsozialarbeit

Puna sociale shkollore

Puna sociale shkollore është një ofertë e shkollës popullore. Puna sociale shkollore qëndron falas në dispozicion të prindërve, fëmijëve, të rinjve, mësuesve, drejtorive shkollore dhe anëtarëve të organeve kompetente.

Punonjëset dhe punonjësit socialë të shkollës këshillojnë dhe shoqërojnë në rastin e problemeve dhe vështirësive sociale dhe/ose të edukimit ose bëjnë ndërmjetësimin për më tutje tek shërbimet e tjera shkollore ose ofertat ndihmuese.

Oferta e punës sociale shkollore në vend është me prag të ulët, kjo do të thotë se është për fëmijët dhe të rinjtë e lehtë për të hyrë në kontakt me të dhe ka të bëjë me kohë pritjeje të shkurta.

Qëllimi i punës sociale shkollore është të përmirësojë mirëqënien personale, shkollore, dhe sociale të nxënësve dhe nxënësve dhe njëkohësisht të përkrahë mësuesit në punën e tyre. Me intervenimet dhe aktivitetet në fusha të ndryshme puna sociale shkollore jep një kontribut të vazhdueshëm në zhvillimin e shkollës.

Punonjëset dhe punonjësit socialë kanë një shkollim në punën sociale (pedagogjia sociale, puna sociale ose animacioni social-kulturor), kanë eksperiencë profesionale në punën dhe këshillimin e të rinjve dhe prindërve si edhe kualifikime specifike në këshillimin sistematik.

Prill 2010